

WE ARE YOUR DOL



Department of Labor

A proud partner of the American Job Center network

# QENDRAT E KARRIERËS SË SHTETIT TË NEW YORKUT

Shërbime të Përshtatshme Kërkimi Pune PA KOSTO  
Qendra e Nju Jorkut

## KËSHILLIM PËR KARRIERË DHE NDIHMË PËR SHKRIM CV

Këshilluesit tanë do t'ju ndihmojnë të vlerësoni nevojat, aftësitë dhe interesat tuaja. Ata do t'ju udhëzojnë përmes një procesi hap pas hapi, për t'ju ndihmuar në kërkimin tuaj për punë. Stafit ekspert do t'ju ndihmojë të shkruani dhe hartoni një CV efektive. Ne do t'ju tregojmë se si të përshtatni CV tuaj dhe si t'i tregoni aftësitë tuaja në internet.

## SEMINARE VIRTUALE

Ju mund të merrni pjesë në workshope virtuale në mënyrë të përditshme, me trajnerë drejtpërdrejt:

- Strategjitë e kërkimit të punës
- Menaxhimi i humbjes së punës
- Networking (Krijimi i kontakteve të reja)
- Përgatitja e CV
- Negociatat për pagat
- Aftësitë gjatë intervistimit

## DHOMAT E BURIMEVE

Qendrat tona të Karrierës ofrojnë qasje për përdorim kompjuterash, telefonash, printerash, fotokopjesh dhe faksi pa pagesë.

## BURIME TË KËRKIMIT TË PUNËS, NGJARJE DHE REKRUTIME

Bizneset në të gjithë shtetin e New Yorkut rendisin vendet e lira të punës me Departamentin e Punës. Ju mund të rishikoni lajmërimet e punësimit dhe vendet e hapura të punës në internet duke vizituar: [myjobsny.usnlx.com/](http://myjobsny.usnlx.com/)

Specialistët përkatës mund gjithashtu t'ju ndihmojnë të bëni një kërkim specifik pune. Shumë biznese përdorin qendrat tona për të kryer rekrutime dhe intervista në terren. [statistics.labor.ny.gov/career-zone/career-calendar.shtml](http://statistics.labor.ny.gov/career-zone/career-calendar.shtml)

## QENDRA VIRTUALE TË KARRIERËS

Qendra Virtuale e Karrierës (VCC), faqja kryesore e kërkimit për punë në internet në shtetin e New Yorkut, është krijuar për të ndihmuar njerëzit të gjejnë karrierën e tyre

të ardhshme. Nëpërmjet inteligjencës artificiale të avancuar punëkërkesit mund të përputhin aftësitë dhe përvojën e tyre me mundësitë e disponueshme me bizneset e New Yorkut. [dol.ny.gov/virtual-career-center-ind](http://dol.ny.gov/virtual-career-center-ind)

## ARSIMI BAZË PËR TË RRIUR / ANGLISHTJA SI GJUHË E DYTË

Ne mund t'ju referojmë në kurse pa kosto për t'ju ndihmuar të fitoni një diplomë ekuivalente të shkollës së mesme ose për të përmirësuar aftësitë tuaja në gjuhën angleze.

## COURSERA

Departamenti i Punës i Shtetit të New Yorkut është në partneritet me Coursera, ofruesi kryesor i trajnimeve në internet. Nëpërmjet Coursera, individë të papunë të qytetit të New Yorkut do të kenë qasje në gati 4000 programe në industrinë me rritje të lartë dhe mund të përmirësojnë aftësitë në shkencën e të dhënave, biznesit dhe teknologjisë. Shumë nga këto programe mundësojnë certifikime dhe mund të ndihmojnë në ngritjen e karrierës suaj.

## KLASA PROFESIONALE DHE TRAJNIMI NË PUNË (PËR ATA QË KUALIFIKOHEN)

Ne mund t'ju referojmë trajnime afatshkurtra për karriera afatgjata. *Në varësi të disponueshmërisë së financimit dhe rregulloreve të programit*

## STREHIMI DHE TEKNOLOGJIA ADAPTIVE

Nëse keni një paaftësi dhe keni nevojë për strehim ose ndihmë në mënyrë që të përfitonit plotësisht nga shërbimet e ofruara në Qendrën e Karrierës, ju lutemi njoftoni stafin tonë. Ne disponojmë teknologji përshtatëse për t'ju ndihmuar të keni qasje në burime, duke përfshirë: lexues ekrani, lupa zmadhimi, softuerin e tekstit në të folur, telefonin me tekst TTY, trackball (pajisje lehtësuese për përdorim të kompjuterit), dhe tastierat me butonë të mëdhenj.

## SHKRIM DHE LEXIM DIXHITAL

Shkathtësitë e shkrim-leximit dixhital nevojiten për të kërkuar, për të marrë dhe mbajtur vendin e punës.

Qendrat tona të Karrierës ofrojnë vlerësime dhe trajnime të edukimit dixhital të NorthStar mbi:

**Aftësi Kompjuterike Thelbësore** - Aftësi kompjuterike Bazë; Elemente Bazë të Internetit; Përdorimi i Emailit; programi kompjuterik Windows; Mac OS

**Aftësitë Thelbësore të Softuerit** - Microsoft Word; Microsoft Excel; Microsoft PowerPoint; Google Docs

**Përdorimi i Teknologjisë në Jetën e Përditshme** - Media Sociale; Literaturë në informacion; Aftësitë e Kërkimit të Karrierës; Gjurma dixhitale

## GJENI QENDRËN TUAJ TË KARRIERËS

[www.labor.ny.gov/career-center-locator](http://www.labor.ny.gov/career-center-locator)

## QENDRAT E KARRIERËS SË QENDRËS SË NJU JORKUT

### CAYUGA WORKS

199 Franklin Street, Suite 204  
Auburn, New York 13021  
**315-253-1590**  
[www.cayugacortlandworks.org/](http://www.cayugacortlandworks.org/)

### CORTLAND WORKS

99 Main Street  
Cortland, New York 13045  
**607-756-7585**  
[www.cayugacortlandworks.org/](http://www.cayugacortlandworks.org/)

### OSWEGO COUNTY WORKFORCE NY

200 North 2nd Street  
Fulton, New York 13069  
**315-591-9000**  
[www.ocwny.org/](http://www.ocwny.org/)

### WAMPSVILLE WORKING SOLUTIONS

133 N. Court Street  
Wampsville, New York 13163  
**315-363-2400**  
[www.working-solutions.org](http://www.working-solutions.org)

### CNY WORKS

960 James Street  
Syracuse, New York 13203  
**315-473-8250**  
[www.cnyworks.com](http://www.cnyworks.com)